



TAKIMI



Ministri Imami priti në takim admiralin Sir George Zambellas

Admirali Zambellas nga ana e tij ka shprehur kënaqësinë që ndodhet në Shqipëri në kuadër të stërvitjes së përbashkët që do të organizohet së afërmi në territorin e Shqipërisë dhe për të diskutuar më tej për çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin në fushën e stërvitjes mes FA shqiptare dhe atyre britanike, kryesisht në komponentin detar

faqe 5

PO ZHVILLOHET NË PERIUHDHËN 2 - 18 NËNTOR 2012

Zhvillohet stërvitja e përbashkët me Britaninë e Madhe "ALBANIAN LION-12"

faqe 2

ANALIZA

Mundësitë dhe nevojat mbrojtëse të Europës

DOC.DR. MUHAMET RACAJ, GJENERALBRIGADE

faqe 7

SHSHP të FA, NDOQI PËRGATITJET PËR KONCERTIN E 4 DHJETORIT

Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi inspektoi trupat e rreshtuara gjatë provave për Paradën Ushtarake

faqe 6

PARADA E 100 VJETORIT OSE 300 RRESHTAT E NJË ALFABETI MISTIK



Pjesëmarrja e flamurtarëve të 19 vendeve partnere të NATO-s, vlerësim i madh për Shqipërinë

faqe 8-9

I PRANISHËM ISHTE DHE SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM I FARSH-SË, GJENERALMAJOR GJUNKSHI

Ceremoni përkujtimore për dëshmorët britanikë të rënë në Shqipëri, gjatë Luftës së II Botërore

Kryeministri Berisha dhe ministri i Mbrojtjes Arben Imami zhvilluan homazhe dhe vendosën një kurorë me lule pranë memorialit të dëshmorëve britanikë, duke shprehur nderimet më të thella për sakrificën sublime të ushtarëve britanikë



faqet 5

Edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së gjeneralmajor Gjunkshi priti gjeneralmajor Halbauer Imami me komandantin e KFOR-it: "Misioni i NATO-s në Kosovë një histori suksesi"

Gjeneralmajor Halbauer ka vlerësuar kontributin e trupave dhe të personelit të FA Shqiptare që punojnë në KFOR, duke shprehur falenderime të veçanta për këtë bashkëpunim, si dhe ndau të njëjtin vlerësim me ministrin Imami dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi për situatën në rajon e sidomos në Kosovë, si dhe shprehu gatishmërinë e tij për rritjen e bashkëpunimit në të ardhmen



faqe 3



81 VJET SHTYP USHTARAK/ HISTORIA E REVISTAVE DHE GAZETAVE USHTARAKE NGA 1931 DERI MË SOT

Shtypi ushtarak në 100 vjetorin e FA

Ministri Imami dhe gjeneralmajor Gjunkshi: Shtypi ushtarak ka luajtur një rol të posaçëm në historinë e FA në këto 100-vjet



Konferenca me temë: "Shtypi ushtarak në 100-vjetorin e Forcave të Armatosura-Historia e shtypit ushtarak dhe sfida të pritshme të informimit në FA" u zhvillua në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të shtetit shqiptar si dhe të FA nga QKMBM (Drejtoria e Publikimeve Ushtarake)

"Konteksti historik i shtypit ushtarak", 1912-1931

NGA PROF. DR. BASHKIM GJERGJI

faqe 10-13

TAKIMET E GJENERALBRIGADE BARDHYL HOXHËS

Komandanti i KDS dhe Kursi i Sigurisë dhe Mbrojtjes vizitë në Kosovë

faqe 6

ANALIZA

Kaplan: Gjeografia e fuqisë iraniane

faqet 14

STUDIMI

Evolucioni drejt suksesit i doktrinës së forcave tokësore në shekullin e XXI-të

faqe 15

MERR JETË NJË INSTITUCION I KUJTESËS HISTORIKE TË FA



Muzeu i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (MFA), në prag të inaugurimit

faqe 4

MUNDËSITË DHE NEVOJAT MBROJTËSE TË EUROPËS



DOC.DR. MUHAMET RACAJ,
GJENERALBRIGADE (Maqedoni)

Nga fillimi i viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar Bashkimi Europian dhe vendet e tij anëtare, të shtyrë nga interesi për të ruajtur sigurinë dhe stabilitetin mbrojtës nisën etapën e re në procesin e integritimit, duke vënë një bashkëpunim më të fortë ndërnacional dhe ndërshtetëror. Në Maastricht në vitin 1992 me marrëveshjen për Bashkimin Europian qëllimi ka qenë një bashkim ekonomik dhe monetar (si shtyllë e parë e BE), politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë (shtylla e dytë) dhe bashkëpunimi i ngushtë në jurisprudencë dhe në punët e brendshme (shtylla e tretë). Në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë u bë e mundur që në një moment të caktuar në të ardhmen të instalohet politika e përbashkët mbrojtëse, e cila do të ngrihej në nivel të mbrojtjes së përbashkët.

Vlerësimi rreth kërcënimeve dhe sprovave të sigurisë, me të cilat do të ballafaqohet Evropa nuk e përcakton mundësinë për një sulm masiv ndaj Evropës, por Bashkimi Europian ballafaqohet me kërcënime të reja, mjaft të paparashikueshme dhe të llojllojshme, me përplasje regjionale, përhapje të armëve për shfarosje në masë, rënien e shteteve dhe krimin e organizuar. Përpjekjet për të zgjidhur kërcënimet kyçe e nxitën nevojën për të rishikuar mundësitë dhe nevojat mbrojtëse të Evropës. Gjurmëve për të gjetur mekanizma të rinj mbrojtës, planifikuesit e mbrojtjes, teknologët dhe industrialistët çdo ditë anë e mbanë Evropës marrin vendime, të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në mundësitë mbrojtëse dhe krijojnë bazën teknologjike dhe industriale për njëzet vitet e ardhshme. Atyre që marrin vendime të këtylla, të quajtur “krijues të së ardhmes” u nevojitet ndihma më e madhe e mundshme, që të kuptojnë të ardhmen për të cilën marrin vendime që sot.

Për shembull tezë kryesore që përdoret në studime të këtylla është se do të vazhdojë procesi i globalizimit. Shumë lehtë është që të parashihen skenarë që këtë hipotezë e vënë në pikëpyetje: pandemi masive të pakontrolluara, përdorimi i tepruar i armëve për shkatërrim në masë, ose përforsimi i regionalizimit në marrëdhëniet globale ekonomike, me të cilin shtetet do të mbroheshin nga zhvillimi i barabartë global dhe nga shfrytëzimi. Shumë studime mbështeten në tezën se procesi i globalizimit është pandalshëm se një



gjë të këtyllë të gjithë e kanë pranuar si diçka të kryer. Globalizimi në mënyrë vendimtare ndikon edhe në formimin e Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes Europiane (European Security and Defence Policy, ESDP). Në fakt kapacitetet dhe aftësisë mbrojtëse europiane përcaktohen nëpërmjet Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes Europiane.

Gjithsesi në këtë proces janë përzier edhe nevojat individuale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, por edhe kërkesat e aleancës së NATO-s. Kështu pak a shumë fitohen vizione, plane dhe programe të pavarura, të cilat bashkërisht përbëjnë mundësitë aktuale dhe të ardhshme të shteteve të Bashkimit Europian.

Realisht mund të thuhet se pas plotësimit të nevojave individuale të shteteve dhe nevojave të NATO-s, në radhë vjen shqyrtimi i nevojave të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes Europiane. Nga ana tjetër pozitiv është edhe fakti që nevojat e NATO-s dhe të Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes Europiane janë identike.

Për shkak të gjendjes momentale politike në Bashkimin Europian është fare pak e sigurt se në një të ardhme të afërt nevojat e Politikës së Sigurisë dhe mbrojtjes europiane do të ngrihen mbi nevojat e aleancës së NATO-s dhe të nevojave të veçanta të vendeve anëtare. Edhe përkundër kësaj anëtarët e BE kanë mundur të gjejnë qëllimin kryesor dhe strategjinë evropiane të sigurisë e cila ka për të mbuluar një numër të madhe të sprovash sigurie dhe detyra të mundshme. Kjo përfshinë mundësinë e ndarjes së detyrueshme të palëve në konflikt. Kjo mundësi bazohet në themelet e përvijës të vitit 1999 dhe të nevojave të atëhershme që me forcë të vendoset paqe në Kosovë.

Strategjia parasheh edhe kryerjen e operacioneve të stabilizimit në shtetet në të cilat për shkak të veprimeve terroriste shkaktohet një dobësim ose rënie e sistemit shtetëror. Kjo mjafton që Politika e sigurisë dhe mbrojtjes Evropiane të hartojë një plan mjaft të gjithanshëm për veprim.

Me objektiva të këtylla që në fakt ofron vetëm bazën, janë propozuar

themelet në të cilat duhet të ngrihen aftësitë e reja të sigurisë, duke përfshirë edhe analizat e hollësishme të reja të cilat do të çonin në udhëzime më efektive. Plotësimi i këtyre rekomandimeve do të sjellë zhvillimin e mundësive dhe kapaciteteve mbrojtëse në të ardhmen.

Në kontekstin global

Për çfarë Evrope bëjmë fjalë dhe për çfarë bote? Vetën nëse ngec globalizimi apo nëse merr në drejtim të kundërt, bota në vitin 2025 me siguri do të jetë më e pabarabartë, me tepër e varur në mënyrë reciproke që do të shkaktonte pabarazi edhe më të mëdha. Parashikimet për rritjen e bruto prodhimit kombëtar kinez tregojnë se Kina do të jetë ekonomi e dytë më e fortë, India mund të arrijë Japoninë dhe të zë vendin e tretë. Evropa edhe më tutje do të ketë rritje të qëndrueshme - në të ardhurat kombëtare bruto, ndoshta edhe anëtarët e saj, por përparësia e saj teknologjike në lëmin e teknologjisë informatike, bioteknologji dhe nanoteknologji dalë nga dalë po shkohet.

Evropa në fakt do të ngecë për shkak të shkallës së dobët të rritjes që momentalisht në Evropë është 1,5 %. Numri i popullsisë mund të stagnojë për shkak të lindjeve të pakta, por edhe për shkak të zgjatjes së madhe të jetës. Deri në vitin 2025 përqindja e popullsisë me aftësi punuese (nga 15 deri 64 vjet dhe mbajtja e kufirit për marrje të pensionit) do të rritet nga 37 në 48 për qind. Kështu evropiani mesatar do të jetë me moshë 45 vjeçare. Evropa në vitin 2025 do të ketë vetëm 6 për qind të popullsisë së botës. Pleqëria dhe zvogëlimi i numrit të popullsisë do t'i detyrojë qeveritë evropiane të "importojnë" të rinj dhe punëtorë të arsimuar. Gjersa mungesa e forcës së punës mund të neutralizohet me "import", forcat e armatosura do të gjenden në një pozitë edhe më të vështirë. Në fakt deri në vitin 2025, në Evropë numri i personave të aftë për t'u rekrutuar (nga 16 deri 30 vjet) do të zvogëlohet 15 për qind.

Trendët e këtyllë demografik do të kenë ndikim në sferën e financimeve publike, për shkak se do të kërkohet

rritje e pjesëmarrjes dedikuar sigurimit shëndetësor dhe të pensioneve. Këto kompensime gjatë katër dekadave të ardhshme mund të rriten nga 11 dhe 16 për qind e të ardhurave bruto kombëtare sa janë sot deri në 17 dhe 33 për qind. Rritja e ulët ekonomike dhe rritja e numrit të të papunëve do të ishin si presion shtesë ndaj shpenzimeve shtetërore dhe do t'i detyrojnë ligjvënësit të ndajnë më tepër për të papunët dhe për programe sociale, që patjetër do të shkaktonte ngarkesë për tatimpaguesit dhe kjo gjithsesi do të shkaktonte pengesa edhe për të ndarë mjetet për rroga dhe shpenzime të tjera për personelin ushtarak. Globalizimi padyshim se do të ketë ngadhënjyes dhe të humbur, qoftë ndërmjet shteteve, rajoneve qoftë ndërmjet shoqërive. Sistemet e reja komunikuese edhe më shumë do t'i thellojnë dallimet. Rajonet rreth Evropës do të jenë para sprovave të veçanta. Për shkak të shtimit të madh, numri i popullsisë në Afrikë rritet më shumë se në cilindo vend tjetër të botës, dhe deri në vitin 2025 do të rritet rreth 48 për qind, duke arritur 1,3 milion njerëz, edhe përkundër sëmundjes së sidës. Moshë mesatare e afrikanit do të jetë 22 vjet. Ngrohja globale dhe zgjerimi i shkretëtirave, do ta detyrojnë popullsinë të shpërngulet nëpër qytete më të mëdha (përfshirë Afrika në vitin 2025 do të ketë 11 megaqytete me më shumë se 5 milion banorë). Shumica e popullsisë do të jetë e papunë. Gjithsesi ky do të jetë një vend ideal për të përhapur brengosjen, ku do të krijohen kriza të mëdha humanitare dhe migrime në rajonet më të pasura.

Për nga shkalla e shtimit, Lindja e Mesme do të shtohet edhe më shpejtë se sa Afrika. Popullata e aftë për punë do të shtohet edhe për 50 për qind. Kjo do të shkaktojë problemet e njëjta me papunësinë, ndërsa afër 70 për qind e popullsisë do të vendoset nëpër qytete deri në vitin 2025. Nga ana tjetër, Rusia deri në vitin 2025 me siguri do të humbë 10 për qind të popullsisë. Nuk duhet ndonjë aftësi paragjyquese për të

prognozuar tensionet dhe presionet e mëdha migruese të rajoneve përreth Evropës. Njëkohësisht Evropa do të bëhet gjithnjë e më shumë e varur nga pjesët e tjera të botës, veçanërisht për t'u furnizuar me energji. Vlerësimet janë se deri në vitin 2030 konsumi i përgjithshëm i energjisë do të rritet 50 për qind. Konsumi i naftës do të rritet 40 për qind, ndërsa shpenzimi i gazit do të rritet deri 90 për qind.

Burime të naftës dhe të gazit ka me bollëk, por sa do të ketë qasje tek ato. Deri në vitin 2025 Evropa do të duhet të importojë 90 për qind të naftës dhe 80 për qind të gazit. Njëkohësisht Kina dhe India do ta rrisin në mënyrë konstante shpenzimin e këtyre emergjentëve, duke kërkuar burime të reja në Azi, Afrikë dhe në Lindjen e Afërt. Gjithsesi interesat e sigurisë evropiane do të cenohen drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga tensionet në rritje jo vetëm rreth saj, por edhe në përgjithësi. Njëkohësisht Evropa po bëhet gjithnjë e më shumë e varur nga bota, fqinjët e saj gjithnjë e më tepër do të jenë problematik, liderët e saj do të jenë më të ndjeshëm rreth çështjeve për të ndërmarrë ndonjë intervenim ushtarak. Operacionet ushtarake, veçanërisht jashtë BE do të jenë subjekt i një mbikëqyrje më të madhe nga ana e politikanëve, medimeve dhe qytetarëve. Do rriten shqetësimet e shoqërive dhe të qeverive rreth çështjeve të sigurisë nacionale dhe bashkëjetesës sociale, që do të shkaktonte refuzimin e mundësive për intervenime ushtarake jashtë rajonit të Unionit, veçanërisht në rajonet nga vinë dose do të vijnë numri më i madh i emigrantëve. Pritet që të bëhet vazhdimisht edhe përhapja e kapaciteteve bërthamore, biologjike dhe kimike, që do të komplikonte edhe më shumë marrjen e vendimeve për intervenime ushtarake.

Si pasojë e globalizimit, këtu do të përfshihet gjithashtu edhe çështja e së drejtës ndërkombëtare dhe aspekti legal i ndërhyrjes ushtarake në rajonet e shteteve të pavarura. Kështu, çdo operacion ushtarak, apo vetëm ndonjë veprim që nuk do ta lejonin Kombet e Bashkuara do të konsiderohet si ilegal, që do të shtonte antagonizmat edhe më shumë. Në zbatimin e operacioneve ushtarake vëmendje më e madhe do t'i kushtohet proporcionit dhe logjikës së përdorimit të forcës, duke i dhënë mundësi përforsimit të përgjegjësive individuale, jo vetëm të drejtuesve politik dhe eprorëve më të lartë ushtarak, por edhe oficerëve dhe nënofficerëve të niveleve më të ulëta të komandimit. Ndjeshmëria e operacioneve ushtarake në raport me dëmin e ndërsjellë do të përforcohet edhe më tepër.

Kujdesi i shtuar për ruajtjen e sigurisë kombëtare gjithashtu do të zvogëlonte dallimin ndërmjet asaj që është shënuar si fushë e "mbrojtjes" dhe asaj që quhet fushë e "sigurisë", veçanërisht nëse fitohet përshtypja se po zvogëlohen kërcënimet "konvencionale" siç është mundësia për ndonjë sulm të drejtpërdrejtë ndaj Evropës.

Vazhdon...